

VENDIM
Nr. 806, datë 29.12.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 824, DATË 6.12.2006, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E INSTITUCIONEVE TË AUTORIZUARA PËR
VERIFIKIMIN, NË MËNYRË ELEKTRONIKE, TË GJENDJES GJYQËSORE, SI DHE
TË FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 2, e 11, pika 1, të ligjit nr. 9614, datë 21.9.2006, “Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 824, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika I ndryshohet si më poshtë vijon:

“I. Institucionet, që autorizohen për verifikimin, në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore, janë:

1. Zyra e Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
2. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;
3. Kryeministria;
4. Gjykata Kushtetuese;
5. Prokuroria e Përgjithshme;
6. Prokuroria e Posaçme;
7. Prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
8. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm;
9. Këshilli i Lartë Gjyqësor;
10. Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
11. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
12. Kontrolli i Lartë i Shtetit;
13. Banka e Shqipërisë;
14. Të gjitha ministratë e linjës;
15. Të gjitha institucionet në varësi të Kryeministrit apo të ministrave të linjës;
16. Degët territoriale të ministrave ose institucioneve të varësisë;
17. Njësitë e vetëqeverisjes vendore;
18. Interpoli;
19. Misionet diplomatike, me autorizim të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
20. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, për shërbimet konsullore që ofrohen për shtetasit shqiptarë jashtë Republikës së Shqipërisë;
21. Misioni diplomatik i Bashkimit Evropian në Republikën e Shqipërisë;
22. Zyra e Këshillit të Evropës në Republikën e Shqipërisë;
23. Enti Rregullator i Energjisë;
24. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
25. Autoriteti i Aviacionit Civil;
26. Autoriteti Portual;
27. Shkolla e Magjistraturës;
28. Çdo institucion tjetër shtetëror, që paraqet kërkesë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe pajiset prej saj me kodet hyrëse (*user name* dhe *password*) të regjistrat elektronik të gjendjes gjyqësore.”.

b) Në pikën I/1, fjalët “... legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale ...” zëvendësohen me “... sigurisë së sistemit të të dhënave dhe të fshehtësisë të të dhënave personale të shtetasve ...”.

Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama